

Çfarë duhet
të dini rreth
vaksinimit
kundër
COVID-19
me vaksinën
Pfizer-BioNTech



NYC VACCINE FOR ALL:
SAFE, FREE, EASY

nyc.gov/covidvaccine

Përpara se të largoheni nga ambienti i vaksinimit:

- Nëse kjo është radha e parë e vaksinimit, lini një takim për radhën e dytë. Radhën e dytë duhet të vaksinoheni në të njëjtin vend si dhe radhën e parë. Takimin për dozën e dytë duhet ta lini 21 deri në 42 ditë pas dozës së parë.
- Sigurohuni që të merrni një dokument vaksinimi. Ai do të tregojë se cilën vaksinë keni bërë dhe datën në të cilën e keni bërë. Merreni këtë dokument në takimin për dozën e dytë dhe sigurohuni që të përditësohet për të treguar që i keni marrë të dyja dozat.

Cilat janë efektet anësore të vaksinës?

Efektet anësore të zakonshme janë dhimbja ose ënjtja e krahut në vendin e vaksinës, dhimbje koke, dhimbje trupi, lodhje dhe temperaturë. Efektet anësore janë më të zakonshme pas dozës së dytë dhe më të rralla tek të rriturit në moshë më të madhe. Efektet anësore janë zakonisht:

- Të lehta deri në mesatare
- Fillojnë brenda tre ditëve të para pas vaksinimit (ditën pas vaksinimit është më e zakonshme)
- Pasi fillojnë, ato zgjasin një ose dy ditë

Çfarë të bëj nëse kam efekte anësore?

Telefonojini ofruesit të kujdesit shëndetësor nëse keni efekte anësore që ju shqetësojnë ose që nuk largohen pas disa ditësh, ose nëse pas 24 orësh vendi i vaksinës skuqet ose dhemb. Bisedoni me ofruesin e kujdesit shëndetësor për të marrë ilaçe pa recetë, si p. sh. acetaminofen (Tylenol) ose ibuprofen (Advil).

● ● ●

Merrni dozën e dytë, edhe nëse keni efekte anësore pas dozës së parë, përveç rasteve kur ndalohej nga ofruesi i kujdesit shëndetësor.

● ● ●

Raportoji efektet anësore në aplikacionin për celular V-safe të Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC). Për të mësuar më shumë dhe për të shkarkuar aplikacionin, vizitoni **vsafe.cdc.gov**. Efektet anësore mund t'i raportoni gjithashtu në sistemin e raportimeve të rasteve të efekteve negative (VAERS), i cili menaxhohet nga CDC dhe Administrata për Ushqimet dhe Barnat. Raportimet mund të bëhen në **vaers.hhs.gov/reportevent.html** ose nëpërmjet telefonit në numrin 800-822-7967. Informacioni që raportoni do të jetë konfidencial.

A mund të pësoj reaksion alergjik nga vakcina?

Reaksionet alergjike janë të pazakonta dhe fillojnë kryesisht brenda pak minutash deri në një orë pas marrjes së dozës. Shenjat e një reaksioni alergjik të rëndë përfshijnë vështirësi në frymëmarrje, ënjtje të fytyrës dhe fytit, rrahje zemre të shpeshta, skuqje në të gjithë trupin, marrje mendsh dhe plogështi. Nëse mendoni se po pësoni reaksion alergjik të rëndë, telefononi numrin **911** ose shkoni në spitalin më të afërt.

A duhet të jetë doza e dytë e të njëjtit lloj vakcine si doza e parë?

Po. Meqenëse keni bërë vaksinën Pfizer, doza e dytë duhet të jetë gjithashtu e vaksinës Pfizer.

Çfarë ndodh nëse nuk shkoj dot në takim për dozën e dytë?

Duhet të lini përsëri takim për një kohë sa më të afërt që të mundeni. Merrni dozën e dytë, pavarësisht kohës që ka kaluar që prej dozës së parë.

Kur fillon të funksionojë vaksina?


Ndërkohë që doza e parë ju jep njëfarë mbrojtjeje, vaksina ka më shumë efekt pas dy dozave. Nuk do të keni mbrojtje të plotë nga vaksina deri në dy javë pas dozës së dytë.

A mund t'i ndaloj masat e tjera kundër COVID-19 pasi të vaksinohem?

Jo. Masat parandaluese duhet t'i vijoni ende edhe pas vaksinimit:

- Qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë.
- Qëndroni të paktën 6 këmbë larg personave të tjerë.
- Mbani mbulesë për fytyrën.
- Lani duart dhe përdorni shpesh dezinfektues duarsh.

Ndërkohë që vaksina Pfizer ka treguar që i mbron njerëzit nga COVID-19, ne na duhet të mësojmë më shumë për kohëzgjatjen e mbrojtjes dhe nëse vaksina parandalon transmetimin.



A do të faturohem për vaksinën apo për vizitën shëndetësore?

Jo. Kompania e sigurimit mund të faturohet, por ju nuk do të faturoheni për tarifën e përbashkët ose ndonjë tarifë tjetër për vaksinën.

A mbrohet informacioni im personal?

Informacioni juaj personal është konfidencial dhe i mbrojtur. Informacioni juaj bazë (si emri, adresa, numri i telefonit, data e lindjes, raca dhe etnia, data e vaksinimit dhe lloji i vaksinës së marrë) do t'i jepen Departamentit të Shëndetit dhe Higjienës Mendore të qytetit të Nju Jorkut (Departamenti i Shëndetit i NYC), siç kërkohet nga ligji.

Çfarë të bëj nëse kam pyetje të tjera?

Mund t'i telefononi ofruesit të kujdesit shëndetësor ose numrit **311**.

**Ku mund të marr
më shumë informacion?**



Departamenti i Shëndetit i NYC:
nyc.gov/covidvaccine

Departamenti i Shëndetit i shtetit të Nju Jorkut:
covid19vaccine.health.ny.gov

CDC:
cdc.gov/covidvaccine



Departamenti i Shëndetit i NYC mund t'i ndryshojë
rekomandimet sipas zhvillimit të situatës. **3.8.21**